

EKSPANSIONI I SHQIPES NË GJUHËT ORIENTALE.

Që ekziston një lidhje e fortë e shqipes me gjuhët orientale, kjo ka qenë e njohur shumë kohë më parë, por studimi i kësaj lidhjeje është kushtëzuar nga një qasje e dyshimtë dhe paragjykuese, sikur shqipja është borxhlesha e madhe dhe është vetëm ajo që ka marrë prej atyre gjuhëve. Në pamje të parë, duket sikur ky është një realitet që nuk mund të ishte ndryshe, pasi janë aq shumë studime shkencore e akademike të gjuhës që e kanë pranuar këtë fakt dhe kanë prurje të botuara që "vërtetojnë" tezat e tyre se shqipja ka mbi 5000 orientalizma brenda leksikut të saj. Ndërkaq akademikët tanë "kanë harruar" të kujtohen se Turqia ka qenë banuar nga hititët, të cilët për gjuhë kishin atë që kanë edhe sot shqiptarët e Turqisë moderne, në të cilën rreth 22 milionë banorë janë me origjinë shqiptare dhe 7 milionë flasin ende shqip, duke e bërë Turqinë vendin me më shumë popullsi shqiptare në botë. Por asnjë gjuhëtari e etimologu zyrtar të akademive tona "nuk i shkoka mendja" se kjo popullsi, që ka qenë aty që nga antikiteti i hershëm dhe e furnizuar herë pas here me tjetër popullsi shqiptare nga Iliriku, për shkak të gjenocidit grek dhe serb mbi shqiptarët, të ketë ndikuar duke mbushur fjalorin e turqishtes me shumë fjalë shqipe dhe të ketë dhënë edhe në gjuhët e tjera të orientit. Vetëm një studjues (Tahir. N. Dizdari) "ka gjetur" 4500 orientalizma në gjuhën shqipe dhe, siç thotë akademiku Emil Lafe në parathënien për librin e Dizdarit: "Për fat të mirë kjo vepër e jetës së autorit të vet, me rreth 4500 fjalë, u botua në vitin 2005 nga Instituti Shqiptar i Mendimit dhe i Qytetërimit Islam (AIITC) dhe Organizata Islame për Arsim, Shkencë e Kulturë (ISESCO)".

Akademiku ynë Emil Lafe nuk lë pa lëvdur në parathënien e tij edhe Fondacionin iranian "Saadi Shirazi", që botoi librin e Dizdarit si dhe revistën "Perla" të këtij fondacioni, që del në Tiranë dhe e cila që nga viti 1996 e deri më 2006 botonte në çdo numur rubrikën "persizmat në gjuhën shqipe" e ku kryeredaktor i kësaj reviste ishte prof. dr. Shaban Sinani, dikur sekretar personal i Ramiz Alisë e sot antar i Akademisë së Shkencave Tiranë, ku kryetar është njeriu pa asnjë botim shkencor, z. Skënder Gjinushi i akuzuar në parlamentin shqiptar si i mpleksur në biznesin me skafë në Vlorë.

Interesant është se dy parathëniet për të mbështetur botimin e librit "persizmat në gjuhën shqipe dhe studimi i tyre" u janë shtuar si pasthënie edhe gjashtë shkrime studimore përkrahëse nga pesë akademikë shqiptarë si: Shaban Demiraj, Emil Lafe (edhe redaktor i librit), Feti Mehdiu, Shaban Sinani, Jup Kastrati si dhe vet drejtuesi i fondacionit "Saadi Shirazi" z. Shahruz Falahatpisheh.

Nuk do shkruaja për akademikët sa më lart, sikur optimizmi i tyre për të mbështetur "studime" e çdo vepër që e nxjerr shqipen si gjuha me më shumë huazime në botë, të mos bënte kontrast me heshtjen dhe injorimin e çdo veprë dhe autori që vërteton shkencërisht të kundërtën: se shqipja është më së shumti gjuhë dhënëse dhe qendra e familjes më të madhe të gjuhëve në botë, asaj indevropiane.

Vepra, që unë sjell këtë herë, përmbys mendimin se shqipja ka rreth 5000 orientalizma në fjalorin e saj dhe tregon shkencërisht me prova se shumica e të ashtuquajturave orientalizma në shqipe dhe që kanë ende përdorim të gjerë në gjuhën tonë, janë thjesht fjalë mirfilli të shqipes. Etimologjia, që unë ndjek si metodë, e kërkon të vërtetën e fjalës brenda fjalës dhe ndjek të njëjtën rrugë edhe të tre librave botuar më parë nga unë e të promovuara në shumë vende dhe të njohura edhe nga akademikët e gjuhës shqipe, të cilët s'kanë asnjë fjalë të thonë.

Etimologjia mbështetur në teorinë e embriomorfemave nxjerr krej zbuluar pseudoshkencën e derisotme në etimologji dhe vendos përfundimisht standardin e duhur shkencor në këtë lëmi të shkencës. Akademikët tona as që bëhet fjalë të bëjnë një oponencë për veprën time, pale ta pranojnë teorinë e embriomorfemave. Rrëzimi i "emrave të mëdhenj" të gjuhësisë, si Çabeji, përjetohet si kataklizëm në qarqet akademike, të cilat duhet ta kuptojnë se në të vërtetë Çabeji ka rënë qyshse atë nuk ka kush ta mbrojë shkencërisht. Nuk është faji i përparimit shkencor, që pseudoshkenca zvenitet e tretet para shkencës së vërtetë. Në shkencë, asgjë

fallco nuk mund t'i rezistojë përballjes me origjinalin. Akademikët e sotëm të gjuhës e kanë kuptuar fare qartë se etimologjia që mbështetet mbi krahasimin ka vdekur dhe kjo vdekësirë, që ata respektojnë, nuk mund të dalë në një përballje në mejdanin shkencor. Ndaj m'i refuzojnë oponencat. Gjithë gradat e tyre "shkencore" vlejnë aq sa vlen frika e tyre. Këta akademikë vetëm se shpresojnë se mendësia komuniste, ku vendos partia se cila është shkenca e vërtetë, do t'u ruajë postet, ofiqet dhe vazhdimësinë.

"Mendimtarët e shquar" të akademive tona duhet ta dinë se akademiku është një gladiator i përjetshëm, që për shpatë ka mendimin më të përparuar dhe beson te forca e tij.

Shkencëtari, ashtu si gladiator, edhe mund ta humbë një ndeshje, por nuk i shmanget dyluftimit, sepse askush nuk ia varros me nderime turpin e mospërballjes dhe nuk ia heq kufomën nga arena.

Nëse nëpër akademitë tona ka ndonjë akademik gladiator, si mund ta gjejmë!? Apo të gjithë janë kufoma?!

Mendimi shkencor ka nevojë për mbështetje institucionale, për kritikë e më së shumti për oponencë shkencore korrekte. Kam provuar dy herë të kërkoj zyrtarisht në ASH dhe ASA oponencë për librat e mi dhe akademitë "nuk kanë kohë" për gjëra të tilla.

Kam bindjen e thellë, të mbështetur në prova të dokumentuara, se Akademia e Shkencave dhe Akademia e Studimeve Albanologjike e Tiranës janë dy qendrat më të mëdha të antikombtarizimit shqiptar në botë dhe për këtë premtoj se do ta sjell në një libër si vepër më vete për lexuesit në një të ardhme jo të largët.

Por le të kthehemi tek ajo se çka kam dashur të sjell me këtë libër për "huazimet orientale" në gjuhën shqipe. Deri sot kemi të bëjmë me një strukturë të mirë organizuar kundër gjuhës shqipe që ka punuar pa u ndalur si një orë e saktë zviceriane dhe e konkretizuar në vepra si fjalorë huazimesh e fjalorë etimologjikë, ku shqipja përvijohet në to në kufijtë e inekzistencës. Ndaj në këtë libër jam munduar të sjell një pjesë nga të ashtuquajturat "orientalizma" në gjuhën shqipe ku vërtetohet etimologjikisht se janë shqipërizma të pastra në gjuhët orientale, ballkanike e më gjerë.

Falë teorisë etimologjike të embriomorfemave, ne mund të zbardhim misterin e krijimit të fjalëve, qendrën e gjuhëve dhe përkatësinë e etnicitetit gjuhësor të fjalëve. Në bazë të kësaj teorie qëndron tabela e embriomorfemave unike të shqipes dhe etimologjia e fjalës kthehet në një "proces teknologjik gjuhësor" të njohur e të zbatueshëm saktësisht në mënyrë shkencore. Tashmë, akademikëve zyrtarë të gjuhës, që kanë propoganduar idenë se shqipja është gjuha me më shumë huazime në botë, u dalin ca probleme jo të vogla:

1. të fshehin fytyrat e tyre ose të përballen shkencërisht.
2. të pranojnë publikisht se: ose janë shkencëtarë dhe dinë të mbrojnë shkencërisht veprat e tyre, ose të pranojnë se kanë punuar për të tjera interesa.

Unë nuk di të them emrat se cilat fondacione, shoqata, shtete, individë e ideologji mbështesin gjithë atë punë antishkencore e antikombtare ndaj gjuhës shqipe për ta quajtur zyrtarisht atë 93% të huaj. Por di të tregoj me emra institucionet, veprat dhe autorët e tyre dhe këtë e kam bërë në jo pak raste dhe këto institucione e autorët e këtyre veprave mynxyrë heshtin. Tash di mirë se e vetmja rrugë për t'i ndaluar ata është demaskimi publikisht për çfarë kanë bërë dhe shpënia e tyre në dyert e gjykatës. Kjo do më marrë kohë, por shpirti im nuk është aspak i qetë, derisa ata, që përdhosin pandalim gjuhën e kombit tim, të demaskohen përfundimisht.

Kjo është lufta ime, që dua ta fitoj medoemos dhe e di që do të kem për mbështetje shpirtin e çdo njeriu që respekton të qenit shqiptar dhe beson në vlerat e kombit dhe të gjuhës sonë.

E gjithë shkenca zyrtare e albanologjisë në gjuhësi është përqëndruar për t'i nxjerrë shqiptarët si një popull pa gjuhë të tyre dhe kjo dëshmohet me vepra që kanë botuar dhe me himnizimin që u bëhet autorëve monstra të këtyre veprave pseudoshkencore e në thelb antikombëtare. Fjalorët e shumtë për "huazimet e shqipes" të akademikëve "tanë" dhe të të tjerëve "profesorë", në masën më të madhe të tyre janë punë e organizuar kundër gjuhës shqipe.

Shumëkujt gjendja e huazimeve të shqipes mund t'u duket një lëmsh që nuk i gjendet ana dhe ka të njëjtin kompleks që përjetojmë të gjithë kur na prishet ndonjë pajisje elektrike dhe nuk dimë t'ia gjejmë defektin e na duhet ta shpiejmë tek ustai përkatës, i cili e ka rutinë gjetjen e defektit. Edhe në qendër të studimit e të përcaktimit të një fjale, nëse është huazim apo fjalë vendi, duhet ustallëk dhe përcaktuesi (mjeshtri) duhet të njohë mirë se si funksionon fjala dhe si është montuar ajo. Gjuhësia krahasuese e ndalon me marrëveshje studimin e morfemës. Por morfema është motori i një fjale dhe pa ditur se si është ndërtuar një motor ne kurrë nuk kemi për ta gjetur se ç'funksion kanë pjesët e motorit. Pyetja e parë për ata që pranojnë gjuhësinë krahasuese si shkencë është:

1. PËRSE NUK LEJOHET ZBËRTHIMI I MORFEMËS KLASIKE NË EMBRIOMORFEMA DHE KUJT I PRISH PUNË KJO? Kjo pyetje përndryshe mund të formulohet: në cilën shkencë u ndaluaka të studiohet objekti i shkencës? A nuk është morfema pjesa kryesore dhe e pandryshueshme e fjalës dhe objekt i studimit të morfologjisë?! Nëse një shkencë ndalon me marrëveshje studimin e strukturës kryesore të objektit shkencor (në rastin tonë, të morfemës), a mund të quhet shkencë?!

2. A MUND TË QUHET ETIMOLOG DIKUSH QË NUK DI TË ZBËRTHEJË MORFEMËN NË EMBRIOMORFEMA?

Këto pyetje nuk marrin përgjigje kurrë sepse përndryshe pseudoshkenca jonë albanologjike me përfaqësues Çabejin do të pranonte se ka qenë dhe është pseudoshkencë. Ndaj akademikët heshtin dhe e kanë të pamundur t'i bëjnë oponencë veprës sime, sepse cila gënjeshtër në botë do të pranonte të ballafaqohej me të vërtetën?!

E vërteta, me shfaqjen e saj, zhbën menjëherë gënjeshtërën, ndaj gënjeshtërja nuk ka nevojë të rezistojë dhe të flasë. Kjo po ndodh sot me dy akdemitë e Tiranës. Nuk flasin. Tri protesta kam organizuar në dyert e këtyre akademive dhe i kam shpallur publikisht si organizma antikombëtarë dhe këto heshtin.

Më duhet të tregoj pse etimologjia zyrtare është pseudoshkencë dhe pse ajo vegjeton ende:

Së pari, akademikët tona kanë pranuar se babai i albanologjisë është sllavi Miklosich, i cili, për hir të së vërtetës, nuk ka qenë etimolog. Miklosich-i e ka klasifikuar fjalorin e shqipes në grupe fjalësh që (sipas tij) e kanë prejardhjen nga latinishtja, greqishtja, sllavishtja etj., por kurrë nuk ka bërë etimologji. Ndarja që ai ka bërë për fjalët e shqipes nuk është arsyetuar me motivim shkencor për çdo fjalë tek e tek, por është nisur nga empirizmi se ku përdorej më shumë secila fjalë. Por kjo nuk e bën aspak atë etimolog e aq më tepër baba të albanologjisë!

Së dyti: lufta ideologjike e politike e serbëve dhe platformat e tyre për shfarosjen dhe dëbimin e shqiptarëve nga trojet e tyre etnike kërkonte e kërkon një logjikë mbështetëse nga vetë albanologët shqiptarë, ku ata vetë ta nxirrnin e ta nxjerrin shqipen si gjuhë me më shumë huazime në botë, që shqiptarët të vetëquhen popull pa gjuhën e tyre e rrjedhimisht pa identitet kombëtar, e lehtësisht të deportueshëm nga territoret e tyre. Këtë sprovë antishqiptare e nisi së pari Eqrem Çabej me serinë e veprave të tij "etimologjike" që u botuan në fillim të viteve '70 në Prishtinën e okupuar nga serbët dhe që ka marrë lëvdata nga sllavologët për huazimet sllave që ka pranuar në gjuhën shqipe. Redaktore për gjysmën e veprave "etimologjike" të Çabejit është zonja e zezë e albanologjisë, Anila Omari, e cila edhe ajo vetë ka "gjetur" gati 1000 huazime vetëm nga

serbishtja në gjuhën shqipe. Këtë studiuese e pagëzoi si etimologe vetë akademiku Kolec Topalli, i cili figuron edhe recezent te vepra e Omarit dhe kjo e fundit figuron recezente e Topallit te vepra e tij mynxyrë "fjalor etimologjik i gjuhës shqipe", ku e nxjerr shqipen 93% të huazuar!

Së treti: pasi njohën Miklosich-in si etimolog, për ta përlijur shkombëtarizimin e fjalëve të shqipes, paraqitën si etimologë edhe hartuesit e ca fjalorëve huazimesh të cilët kurrë nuk kishin pretenduar se ishin etimologë. Mjafton të shihni referencat e Çabejit, Topallit e Omarit, ku në veprat e tyre etimologjike kanë për referenca etimologjike nga Tahir Dizdari e Mikel Ndreca. Ky i fundit, në parathënien e fjalorit të vet: fjalor fjalësh të huaja në gjuhën shqipe", shkruan: "Më duhet të them këtu se për shumë fjalë mbetet e paqartë rruga e tyre prej gjuhës burimore e deri në gjuhën shqipe për shkak të mungesës së të dhënave të sakta shkencore. Mirëpo, kur kemi parasysh se misioni i fjalorit nuk është të merret me kërkime etimologjike, por t'i shfrytëzojë ato të gatshme,aq më parë kur fjalori s'ka pretendime më të mëdha se sa të jetë një doracak...". Ndreca e thotë qartë se "nuk merret me kërkime etimologjike", por akademikëve tanë iu duhen sa më shumë referenca dhe në mënyrën më të turpshme për një shkencë, marrin si referencë edhe dikë që thotë se nuk merret me atë shkencë.

Së katërti: nëse gjuhësia krahasuese do ishte shkencë, ajo do studiohej edhe në universitete. Sot në Shqipëri nuk studiohet ndonjë lëndë me emrin etimologji. Çka do të thotë se etimologjia krahasuese nuk është shkencë dhe personalitetet, që nderohen si etimologë, nuk janë të tillë. Misioni etimologjik në Shqipëri ka qenë nxitje serbe për ta nxjerrë shqipen si gjuhë gati 100% të huazuar dhe t'i tregojë botës se kjo arritje është vepër e etimologëve zyrtarë shqiptarë.

Së pesti: Çabeji, Topalli e Omari duhet të kenë patur program të qartë për ta shkombëtarizuar fjalë për fjalë shqipen, pasi nuk ka si shpjegohet ndryshe se, kur gjuhëtari më i madh grek i të gjitha kohërave, i pranuar si i tillë, Γ. Μπαμπινιωτη, në librin e tij "ετυμολογικο λεξικό της νεας ελληνικής γλώσσας" thotë se fjalët kallamoq, kukurec, kullandris, llapa, llucë, merimangë, bark, plaçkë, zverk, cigun, çupë, etj. janë fjalë që greqishtja i ka marrë nga shqipja, tre "korifejtë tanë" të etimologjisë zyrtare thonë saktësisht të kundërtën, sikur ato fjalë në shumicën e tyre janë greke!!

Teknologjia e shkombëtarizimit të shqipes nëpërmjet akademikëve shqiptarë është suksesi më i madh serb kundër shqiptarëve. Tashmë në çdo universitet të botës, kur mbahen leksione për huazimet, si shembull për një gjuhë me rekordin më të madh të huazimeve, merret shqipja dhe nuk harrohet të thuhet se "këtë e kanë pranuar vetë akademikët shqiptarë"!

Që akademikët shqiptarë kanë bërë trafikim të organeve (fjalëve) të gjuhës shqipe, tashmë e di edhe bufi. Por, që ata duhet të gjykohen për një pabesi të tillë ndaj kombit të tyre dhe të vendoset drejtësia, duhet doemos një ndërgjegjësim i madh dhe një ndërmarrje serioze ligjore, kur dhe ligji është i korruptuar. Por kjo është lufta jonë për ekzistencë dhe ne nuk duhet kurrsesi ta humbim!

Jetojmë në një Shqipëri, ku ministri i jashtëm grek, Kocias, deklaroi se shteti grek jep rreth 52 milionë euro në vit nga një buxhet sekret për institucione të rëndësishme në Shqipëri dhe për personalitete të spikatura të sferës publike dhe ky fakt nuk përbën as lajm, pale të ndiqet se përse paguhet kaq shumë... Por ne dimë se ASH dhe Akademia e Studimeve Albanologjike e Tiranës kurrë nuk ka hartuar e botuar ndonjë vepër historike për gjenocidin grek mbi shqiptarët.... Duket se paratë greke e kanë bërë punën e vet. Ndërkohë është më se e njohur se shteti serb ka patur çdo vit rreth 40 milionë dollarë buxhet për Shqipërinë. Ku venë gjithë këto pará?! Kush i ka penguar dy akademikët tona të bëjnë një vepër të mirfilltë historike për gjenocidin e përsëritur serb mbi shqiptarët? Sa është pasuria e akademikëve tanë një për një dhe a e justifikojnë dot ata pasurinë?

Jetojmë në një Shqipëri ku Presidenti deklaroi në media se kryeministri shqiptar punon për interesat e lobit serb në Shqipëri dhe vetë kryeministri hesht dhe heshtin edhe gjithë ato media....dhe heshtja e vet kryeministrit të bind më shumë se deklarata bombë e presidentit.

Në një të tillë Shqipëri, disave si unë, u duhet të bëjnë shkencë, e cila duhet certifikuar në akademitë që përmendëm më sipër, që një zot e di se a financohen të mos punojnë, apo edhe të punojnë kundër kombit shqiptar. Asgjë në të mirë të albanologjisë nuk gjen hapësirë në dy akademitë tona e sidomos kur studimet vijnë nga jashtë këtyre akademive. Biles vepra më antishkencore dhe më antikombëtare "Fjalor Etimologjik i Gjuhës Shqipe" e përgatitur në Akademinë e Studimeve Albanologjike të Tiranës, që e paravendos shqipen me 93% të leksikut të huaj, nderohet me çmim të parë në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë!!

Mund të themi saktësisht se Akademia e Shkencave e Shqipërisë dhe Akademia e Studimeve Albanologjike e Tiranës janë vegla ideologjike në duart e një politike të huaj dhe armiqësore ndaj kombit shqiptar dhe kjo duket qartë nga produkti antishqiptar i këtyre dy akademive.

Ky fjalor etimologjik jo vetëm sjell etimologjitë e sakta të fjalëve të trafikuar të shqipes dhe i rikthen shkencërisht ato sërish në fondin themelor të burimit të shqipes, por është dhe një akuzë e pastër ndaj akademive tona zyrtare, që shqipen, këtë origjinë të gjithë familjes indoevropiane të gjuhëve, ta paraqesin si një grumbull shkërmoqjesh nga gjuhët e tjera. Koha është ta lëvizim ndryshe rrotën e shkencës dhe të vërtetën e madhe, që shqipja ka mbrujtur që nga muzgu i shoqërisë njerëzore, ta bëjmë të dukshme, të thjeshtë e shkencërisht të pakundërshtueshme. Tash era po fryn për në drejtimin e rrugës sonë.